

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

DIAGNOSTIKIM-MENAXHIM NE AUTOSERVIS

Niveli V i KSHK (pas të mesmes)

Kohëzgjatja: 1 vit mësimor

Kodi: M1-V-10

(Hartuar me mbështetjen e Programit CARDS-VET të BE)

Miratoi:

MINISTRI

Myqerem Tafaj

Tiranë, 2010

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional pas të mesmes në profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niv. V i KSHK.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK.**
 - 1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK.
 - 2. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK.
 - 3. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK.
- III. Plani mësimor për profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK, me kohëzgjatje 1 vit mësimor**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin, provimet dhe certifikatën.**
- VII. Përshkruesit e moduleve profesionale.**

I. Qëllimet e arsimit profesional pas të mesmes në profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK, është *“përgatitja e nxënësve me kompetencat profesionale të nevojshme për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me profesionin e automekanikut në funksione të diagnostikimit dhe të menaxhimit në autoservise, kryesisht për automjetet e lehta”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale në nivelin pas të mesëm, u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen:

- Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në degën “Automekanik”.
- Individë që kanë përfunduar shkollimin për “Automekanik” trevjeçar dhe më pas kanë kryer maturën në gjimnaze.
- Individë që punojnë në sektorin e shërbimeve të automjeteve dhe që janë të aftë të demonstrojnë aftësi të nivelit V i KSHK, në këtë sektor.
- Individë që kanë mbaruar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe që kanë kryer kursin urë për “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”.
- Individë që janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MASH përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Diagnostikim-menaxhim në

autoservis”, niveli V i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të kryejë veprimtari menaxhimi dhe organizimi në autoservise.
- Të zbatojë kuadrin ligjor specifik për profesionin e automekanikut.
- Të trajnojë punonjësit e rinj (çirakët) për aspekte të profesionit në shërbimet e automjeteve të lehta.
- Të mbikqyrë, vlerësojë, udhëzojë, mbështesë dhe motivojë punonjësit e tjerë të autoservisit.
- Të vlerësojë dhe korrigjojë veprimtarinë e aktivitetit në autoservis.
- Të zhvillojë imazhin dhe mbështesë modernizimin e biznesit
- Të garantojë cilësinë e shërbimeve në autoservis.
- Të përgatitë vendin, pajisjet dhe materialet e punës për diagnostikimet në automjetet e lehta.
- Të kryejë matje dhe kontrole për diagnostikimin e automjeteve të lehta.
- Të kryejë diagnostikime të sistemeve dhe mekanizmave të motorëve të automjeteve të lehta.
- Të kryejë diagnostikime të sistemeve dhe agregateve të automjeteve të lehta.
- Të kryejë diagnostikime me kompjuter të automjeteve të lehta.
- Të përcaktojë procedurat e riparimit të parregullsive të diagnostifikuara.
- Të kryejë llogaritje ekonomike për proceset e punës në shërbimet e automjeteve të lehta.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për diagnostikimin dhe riparimin e automjeteve të lehta.
- Të komunikojë me etikë profesionale me klientët dhe kolegët.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të automjeteve të lehta.
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes së mjedisit gjatë diagnostikimit të automjeteve të lehta.

3. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimimit në profilin mësimor “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK.

Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli IV arsimor, e pajis nxënësin me certifikatën e diagnostikuesit-menaxhuesit në shërbimet e automjeteve të lehta, sipas nivelit 5 të draftit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ky kualifikim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës si diagnostikues i parregullsive të automjeteve të lehta dhe si menaxhues në ndërmarrje dhe servise të shërbimeve të automjeteve të lehta.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit të mëtejshëm në arsimin e lartë në degën e Inxhinerisë së transportit ose degë të tjera të përafërta.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK, me kohëzgjatje 1 vit mësimor.

Plani mësimor për profilin mësimor “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK.			
Nr	Kodi	Modulet mësimore	Orët mësimore
1	M-17-394-10	Parime të menaxhimit dhe të ekonomisë në autoservis	42
2	M-18-395-10	Diagnostikimi në sistemet elektrike të automjetit	120
3	M-18-396-10	Diagnostikimi i mekanizmave dhe sistemeve të motorit	132
4	M-18-397-10	Diagnostikimi i elementeve të transmisionit të fuqisë në automjet	120
5	M-18-398-10	Diagnostikimi i sistemit të frenimit të automjetit	108
6	M-18-399-10	Diagnostikimi i sistemit të drejtimit të automjetit	102
7	M-18-400-10	Diagnostikimi i sistemeve ndihmëse të automjetit	108
8	M-18-401-10	Diagnostikimi i sistemit të karrocërisë së automjetit	78
9	M-18-402-10	Diagnostikimi i sistemit të ecjes së automjetit	90
10	M-18-403-10	Diagnostikimi me kompjuter i parregullsive të automjetit	120
11	M-27-404-10	Bazat e trajnimit për kompetenca pune	30
		Gjithsej	35 javë (1050 orë)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor në arsimin profesional për “Diagnostikim-menaxhim në autoservis” në nivelin V i KSHK, pas të mesmes, zgjat 1 vit mësimor (35 javë x 5 ditë/javë x 6 orë/ditë = 1050 orë mësimore).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK, përbëhet nga modulet profesionale teoriko-praktike (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe. Renditja e realizimit të moduleve bëhet nga vetë shkolla, duke konsideruar parimet didaktike bazë (nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, nga niveli i ulët te më i larti, nga teoria te praktika, etj.), si dhe kushte konkrete të shkollës. Për të rritur eficiencën e procesit mësimor, mund të realizohen paralelisht dy ose më shumë module, si dhe mund të zbatohet ndarja në grupe e nxënësve.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e moduleve profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e moduleve profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të

teorisë me praktikën në to, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale që ofrojnë profilin mësimor “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK.

Mësuesit duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës dhe punës. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik dhe praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilin profesional “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK.

VI. Udhëzime për vlerësimin, provimet dhe certifikatën.

Vlerësimi vjetor i nxënësve për modulet profesionale bëhet nga vetë mësuesit përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) për modulet teoriko-praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të arsimimit për “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK, pas të mesëm, nxënësit i nënshtrohen provimeve të mëposhtme:

a) Provimi teorik profesional (test me shkrim)

b) Provimi praktik profesional (realizimi i një detyre praktike për organizimin e punës dhe kryerjen e diagnostikimit të një ose disa parregullsive në automjetet e lehta).

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehjeve, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale të profilin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, niveli V i KSHK. Me përfundimin e sukseshëm të shkollimit, nxënësit marrin Certifikatën e aftësisë profesionale, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MASH, kjo dëshmi përmban:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet (notat) e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në modulet profesionale;
- rezultatet e dy provimeve përfundimtare.

VII. Përshkruesit e moduleve profesionale

1. Moduli “Parime të menaxhimit dhe të ekonomisë në autoservis”

Profili: Diagnostikim-menaxhim në autoservis

Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PARIME TË MENAXHIMIT DHE TË EKONOMISË NË AUTOSERVIS	M-17-394-10
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i njeh nxënësit me rregullat e sigurimit teknik e mbrojtjes së mjedisit, me parimet dhe procedurat e menaxhimit të autoservisit dhe të llogaritjeve ekonomike bazë në autoservis, si dhe i aftëson ata që ti zbatojnë këto rregulla, parime dhe procedura gjatë punës në autoservis.	
Kohëzgjatja e modulit	42 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat profesionale në degën “Mekanik automobilash”, 5-vjeçare ose 3-vjeçare + 2 vite gjimnaz. - Individë që punojnë në shërbimet e automjeteve dhe që janë të aftë të demonstrojnë aftësi të nivelit 4 në shërbime automobilash.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në autoservis Përmbajtja: - Uniforma e punës së automekanikut. - Kujdesi dhe përgatitja e vendit të punës - Rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës - Rregullat e sigurimit teknik në paisje dhe makineri - Rregullat e mbrojtjes së mjedisit në autoservis. - Rregullat dhe këndi i mbrojtjes ndaj zjarrit - Kutia e ndihmës së shpejtë. - Dhënia e ndihmës së parë - Mjedisi pushues në autoservis. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: - të përshkruajë uniformën e punës dhe të demonstrojë veshjen e saj - të tregojë si përgatitet vendi i punës në autoservis - të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik sipas postit të	

-
- punës dhe rregullores përkatëse.
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në paisje e makineri si psh; lift, presë, trapan bango, aparat saldimi, gur smeril, paisje çentrimi disqesh, paisje çmontimi gomash etj.
 - të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit
 - të përshkruajë rregullat e mbrojtjes ndaj zjarrit
 - të demonstrojë përdorimin e kutisë së ndihmës së shpejtë.
 - të demonstrojë dhënien e ndihmës së parë për të dëmtuarit në punë
 - të përshkruajë këndin për mbrojtjen ndaj zjarrit
 - të demonstrojë hapat që ndiqen për mbrojtjen në rast zjarri
 - të përshkruajë një mjedis pushues në autoservis.

RM 2 Nxënësi përshkruan organizimin e punës në autoservis dhe legjislacionin përkatës

Përmbajtja:

- Funksionet dhe detyrat kryesore të personelit në një autoservis
- Strukturat organizative, rolet dhe përkrahjet e punës në autoservis
- Ndarja e detyrave dhe organizimi i vogël i punës në autoservis
- Llojet dhe format ligjore të bizneseve në fushën e shërbimit në autoservis
- Paragrafe nga legjislacioni i punës që lidhen me fushën e shërbimit në autoservis
- Rregulla të etikës profesionale dhe të komunikimit në autoservis
- Legjislacioni fiskal që i referohet bizneseve në fushën e shërbimit në autoservis

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të tregojë cilat janë funksionet dhe detyrat kryesore në një autoservis
- të përshkruajë strukturat organizative, rolet dhe përkrahjet e punës në një autoservis
- të tregojë si bëhet ndarja e detyrave dhe organizimi i vogël i punës në një autoservis
- të përshkruajë llojet e bizneseve në punimet e shërbimit në autoservis.
- të përshkruajë format ligjore të organizimit të bizneseve në fushën e shërbimit në autoservis.
- të përshkruajë legjislacionin e punës që lidhet me veprimtarinë në fushën e shërbimit në autoservis
- të përshkruajë rregullat e etikës profesionale dhe të

komunikimit në autoservis

- të pershkruaje legjislacionin fiskal qe i referohet bisneseve ne fushen e sherbimit në një autoservis

RM 3 Nxënësi menaxhon veprimtarinë në autoservis.

Përmbajtja:

- Parimet bazë të menaxhimit të një biznesi të vogël.
- Planifikimi dhe hartimi i grafikut të shpërndarjes kohore të punës
- Mbikqyrja e zbatimit të orarit të punës.
- Përpilimi i listë-prezencës në autoservis.
- Rishpërndarja e punës në rast mungese të punonjësve
- Mbikqyrja e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit
- Mbikqyrja e punës së punonjësve.
- Marrja e masave për garantimin e cilësisë.
- Vlerësimi i performancës së punonjësve dhe motivimi i tyre
- Kujdesi për cilësinë e kushteve të punës në autoservis.
- Marrja e masave për zhvillim profesional të punonjësve.
- Ndërmjetësimi për zgjidhje problemesh
- Zhvillimi i imazhit të biznesit të autoservisit.
- Krijimi i kushteve për modernizimin e biznesit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të pershkruajë parimet bazë të menaxhimit të një biznesi të vogël.
- të bëjë planifikimin dhe hartimin e grafikut të shpërndarjes kohore të punës
- të mbikqyrë zbatimin e orarit të punës nga punonjësit
- të përpilojë listë-prezencën e punonjësve.
- të bëjë rishpërndarjen e punës në rast mungese të punonjësve për të siguruar vazhdimësinë e punës në autoservis.
- të mbikqyrë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit
- të mbikqyrë veprimtaritë e punës së punonjësve.
- të mbajë shënime për performancën e punonjësve dhe të bëjë motivimin e tyre.
- të kujdeset për sigurimin e kushteve të mira të punës në autoservis.
- të marrë masa për zhvillimin profesional të punonjësve.
- të bëjë ndërmjetësin midis punonjësve dhe stafit drejtues për probleme të ndryshme që mund të dalin
- të marrë masa për zhvillimi i imazhit të biznesit të autoservisit
- të krijojë kushtet e duhura për modernizimin e autoservisit

RM 4 Nxënësi komunikon me klientët.

Përmbajtja:

- Pritja dhe akomodimi i klientit (të simuluar).
- Informimi i klientëve
- Përdorimi i teknikave të ndryshme të komunikimit me klientët.
- Trajtimi i individualizuar i klientit.
- Krijimi i mjedisit dhe i kushteve të përshtatshme për klientët
- Udhëheqja e bisedave tregtare për klientë të rinj.
- Udhëheqja e bisedave tregtare kur njihet paraprakisht klienti dhe kërkesat e tij.
- Njohja e klientëve me proceset e ndryshme të shërbimit dhe karakteristikat cilësore të tyre.
- Nxitja e klientëve
- Përshtatja ndaj reagimit të klientëve.
- Teknikat e shërbimit për klientë me pretendime.
- Komunikimi e bindja e klientit nëpërmjet telefonit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të bëjë pritjen dhe të akomodimin e klientëve sipas rregullave të komunikimit.
- të informojë klientët për shërbimet që ofrohen në autoservis
- të përdorë teknika të ndryshme të komunikimit me klientët.
- të zgjedhë mënyrën më të përshtatshme të komunikimit në vartësi të klientit e karakteristikave të tij.
- të bëjë trajtimin e individualizuar të klientëve.
- të krijojë mjedisin dhe kushtet e përshtatshme për klientët me qëllim bërjen e tyre klientë të rregullt
- të udhëheqë biseda tregtare si për klientët të rinj ashtu dhe për ata ekzistues.
- të njohë klientët me proceset e ndryshme të shërbimit dhe karakteristikat cilësore të tyre.
- të bëjë nxitjen e klientëve nëpërmjet ofertave ose përdorimit të nxitësve të tjerë profesionale.
- të përshtatet ndaj reagimit të klientit.
- të zotërojë teknikat e shërbimit për klientë me pretendime.
- të komunikojë dhe të bindë klientët nëpërmjet telefonit

RM 5 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve të shërbimit në autoservis

Përmbajtja

- Kostot në punimet e shërbimit në autoservis, perberesit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.

-
- Kostoja e punes (pagat, sigurimet shoqerore, etj.).
 - Kosto te tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
 - Detyrimet fiskale ne bizneset e vogla te sherbimit te automobilave te lehte, llogaritja e tyre.
 - Te ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit ne nje biznes te vogel per sherbimet e automobilave te lehte.
 - Hartim i preventivit dhe përgatitja e faturës, për shërbimin e kryer në autoservis

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të tregojë ç'eshte kostoja ne punimet e sherbimit te automobilave te lehte dhe rendise perberesit e koston.
- të beje preventivin (listen) e materialeve per nje punim te dhene.
- të tregojë ç'eshte kostoja per materialet.
- të llogarise koston per materialet për nje punim te dhene.
- të tregojë ç'eshte kostoja e punes.
- të llogarise koston e punes (pagat, sigurimet shoqerore, etj.), ne nje biznes te vogel per sherbimet e automobilave te lehte.
- të tregojë cilat jane kostot e tjera (kostot administrative, transport, energji, amortizim pajisjesh dhe ndertesash etj.).
- të llogarise kostot e tjera per sherbimet që kryhen ne nje autoservis
- të percaktoje detyrimet fiskale per sherbimet që kryhen ne nje autoservis
- të llogarise koston totale te nje punimi te dhene
- të llogarise çmimin e një punimi te dhene në autoservis
- të përgatisë faturën përfundimtare të një shërbimi të kryer

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet te trajtohet ne klase.
 - Instruktori duhet te perdore sa me shume te jete e mundur ilustrime, ushtrime dhe shembuj konkrete llogaritjeje, ne funksion te sqarimit te koncepteve ekonomike dhe ligjore qe trajtohen ne modul.
 - Nxënësit duhet te angazhohen ne ushtrime e praktikime te llogaritjeve te ndryshme ekonomike per nje punim te dhene, ne sherbimet e automobilave te lehte. Ata duhet te perfshihen ne diskutime ne lidhje me çeshtjet e ndryshme qe trajtohen.
 - Rekomandohet qe nxënësve t'u jepen dhe detyra shtepie me llogaritje te ndryshme ose studim te legjislacionit perkates.
 - Gjate vleresimit te nxënësve, duhet te synohet sa me shume kontrolli i demonstrimit praktik te njohurive te fituara.
-

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit.	Per realizimin si duhet te modulit eshte e domosdoshme te sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e meposhtme: – Klase per mesim teorik. – Pajisje kancelarie. – Makina llogaritese dore. – Permbledhje e legjislacionit ne fushen e sherbimeve te autoservisit (kodi i punes, legjislacioni fiskal). – Dokumentacion teknik per autoservis – Modele te dokumetacionit financiar dhe fiskal.
--	---

2. Moduli “Diagnostikimi në sistemet elektrike të automjetit”

Profili: Diagnostikim-menaxhim në autoservis

Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kod	DIAGNOSTIKIMI NË SISTEMET ELEKTRIKE TË AUTOMJETIT	M-18-395-10
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i njeh nxënësit me shkaqet e parregullsive dhe me procedurat e diagnostikimit të elementeve të ndryshme të sistemeve elektrike të automjeteve, si dhe i aftëson ata që t'i zbatojnë këto procedura.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat profesionale në degën “Mekanik automobilash”, 5-vjeçare ose 3-vjeçare + 2 vite gjimnaz. - Individë që punojnë në shërbimet e automjeteve dhe që janë të aftë të demonstrojnë aftësi të nivelit 4 në shërbime automobilash.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësi përshkruan sistemet elektrike në automjete, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. Përmbajtja: - Bateritë, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. - Sistemi i lëshimit, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. - Sistemi i furnizimit me rrymë elektrike, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. - Sistemi i ndezjes së përzjerjes djegëse, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. - Sistemi i ndriçim-sinjalizimit, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. - Sistemi elektrik i pajisjeve ndihmëse, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. - Veglat, pajisjet dhe instrumentat që përdoren për diagnostikimin e sistemit elektrik të automjetit. - Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit elektrik të automjetit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e baterisë dhe tregojë parregullsitë kryesore e shkaqet e tyre. - të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të lëshimit dhe tregojë parregullsitë kryesore e shkaqet e tyre.

-
- të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të furnizimit me rrymë elektrike dhe tregojë parregullsitë kryesore e shkaqet e tyre.
 - të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të ndezjes së përzierjes djegëse dhe tregojë parregullsitë kryesore e shkaqet e tyre.
 - të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të ndriçim-sinjalizimit dhe tregojë parregullsitë kryesore e shkaqet e tyre.
 - të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit elektrik të pajisjeve ndihmëse dhe tregojë parregullsitë kryesore e shkaqet e tyre.
 - të përzgjedhë dhe përdorë veglat, pajisjet dhe instrumentat për diagnostikimin e sistemit elektrik të automjetit.
 - tregojë cilat janë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit elektrik të automjeti

RM 2 Nxënësi diagnostikon parregullsitë në bateritë e automjeteve.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e baterisë.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumentave për diagnostikimin e baterisë.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik të automjetit.
- Procedurat për diagnostikimin e baterisë.
- Kontrolli pamor i gjendjes së jashtme të baterisë dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli me instrument matës i gjendjes së poleve të baterisë dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i nivelit dhe i dendësisë së elektrolitit të baterisë dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i tensionit në polet e baterisë (pa ngarkesë) dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli për rrjedhje elektrike (shkarkim) të baterisë dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i kapacitetit të baterisë (me ngarkesë) dhe përcaktimi i parregullsive.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsive të diagnostikuara të baterisë.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin dhe riparimin e baterisë.
- Llogaritjet ekonomike për riparimin e parregullsive të baterisë.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të baterisë së automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të parapërgatitë vendin e punës dhe automjetin për të mundësuar diagnostikimin e baterisë.
- të përzgjedhë vegla, pajisjet dhe instrumentat e duhura për diagnostikimin e baterisë.
- të marrë informacion paraprak për parregullsitë e baterisë dhe të konsultohet me dokumentacionin teknik përkatës.
- të përzgjedhë procedurat e duhura për diagnostikimin e baterisë.
- të bëjë kontrollin pamor të gjendjes së jashtme të baterisë dhe përcaktimin e parregullsisë.
- të bëjë kontrollin me instrument matës të gjendjes së poleve të baterisë dhe përcaktimin e parregullsisë.
- të bëjë kontrollin e nivelit dhe të dendësisë së elektrolitit të baterisë dhe përcaktimin e parregullsisë.
- të bëjë kontrollin e tensionit në polet e baterisë (pa ngarkesë) dhe përcaktimin e parregullsisë.
- të bëjë kontrollin për rrjedhje elektrike (shkarkimin) e baterisë dhe përcaktimin e parregullsisë.
- të bëjë kontrollin e kapacitetit të baterisë (me ngarkesë) dhe përcaktimin e parregullsisë.
- të marrë masat e duhura dhe të ndajë detyrat për riparimin e parregullsisë të diagnostikuara.
- të plotësojë dokumentacionin teknik për diagnostikimin dhe riparimin e baterisë.
- të kryejë llogaritjet ekonomike për riparimin e parregullsisë të baterisë.
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të baterisë së automjetit.

RM 3 Nxënësi diagnostikon parregullsitë në sistemin e lëshimit të automjeteve.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e sistemit të lëshimit.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumentave për diagnostikimin e sistemit të lëshimit.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik të automjetit.
- Procedurat për diagnostikimin e sistemit të lëshimit.
- Kontrolli pamor i gjendjes së jashtme të sistemit të lëshimit dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli i funksionimit të sistemit të lëshimit me anë të dëgjimit të zhurmave dhe vëzhgimit të reagimit të fluksit të ndriçuesve kryesorë dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli i rrymës së startimit të motorinos, me anë të ampermetrit induktiv dhe përcaktimi i parregullsisë.

- Kontrolli i rënies së tensionit në polet e baterisë, në momentin e startimit dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i rezistencës së izolimit të qarkut të motorinos.
- Kontrolli i tokëzimit të qarkut elektrik të motorinos dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i gjendjes elektrike të solenoidit dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i funksionimit të çelësit të kuadrit dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i gjendjes mekanike të pjesëve të motorinos së zmontuar dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i parametrave elektrike të pjesëve të motorinos së zmontuar dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i gjendjes dhe funksionimit të pinjonit të motorinos së zmontuar dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i gjendjes dhe funksionimit të solenoidit të zmontuar dhe përcaktimi i parregullsive.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsive të diagnostikuara.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin dhe riparimin e sistemit të lëshimit.
- Llogaritjet ekonomike për riparimin e parregullsive të sistemit të lëshimit.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit të lëshimit të automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të parapërgatitë vendin e punës dhe automjetin për të mundësuar diagnostikimin e sistemit të lëshimit.
- të përzgjedhë vegla, pajisjet dhe instrumentat e duhura për diagnostikimin e sistemit të lëshimit.
- të marrë informacion paraprak për parregullsitë e sistemit të lëshimit dhe të konsultohet me dokumentacionin teknik përkatës.
- të përzgjedhë procedurat e duhura për diagnostikimin e sistemit të lëshimit.
- të bëjë kontrollin pamor të gjendjes së jashtme të sistemit të lëshimit dhe përcaktimin e parregullsive.
- të bëjë kontrollin e gjendjes së parametrave elektrike dhe të funksionimit të elementeve të ndryshëm të sistemit të lëshimit me përdorimin e instrumentave dhe aparateve përkatëse.
- të përcaktojë drejt parregullsitë e elementeve të sistemit të lëshimit.

- të marrë masat e duhura dhe të ndajë detyrat për riparimin e parregullsive të diagnostikuara.
- të plotësojë dokumentacionin teknik për diagnostikimin dhe riparimin e sistemit të lëshimit.
- të kryejë llogaritjet ekonomike për riparimin e parregullsive të sistemit të lëshimit.
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit të lëshimit të automjetit.

RM 4 Nxënësi diagnostikon parregullsitë në sistemin e furnizimit me rrymë elektrike të automjeteve.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e sistemit të furnizimit me rrymë elektrike.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumentave për diagnostikimin e sistemit të furnizimit me rrymë elektrike.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik të automjetit.
- Procedurat për diagnostikimin e sistemit të furnizimit me rrymë elektrike.
- Kontrolli pamor dhe dëgjimor i gjendjes dhe i funksionimit të elementeve të sistemit të furnizimit me rrymë elektrike dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli në ngarkesë i tensionit dhe i rrymës në dalje të alternatorit (gjeneratorit) dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i tensionit në dalje të rregullatorit në ngarkesë minimale dhe maksimale, si dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli me oshiloskop i shkallës së radrizimit të tensionit në dalje të alternatorit dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i rezistencës së izolimit dhe i rezistencës së tokëzimit të sistemit të furnizimit me rrymë elektrike dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i gjendjes së funksionimit të alternatorit, rregullatorit dhe qarkut të furnizimit, me anë të lidhjes “by pass” (lidhjes së shkurtër), si dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i gjendjes mekanike dhe parametrave elektrikë të pjesëve të alternatorit dhe rregullatorit të zmontuara, si dhe përcaktimi i parregullsive.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsive të diagnostikuara.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin dhe riparimin e sistemit të furnizimit me rrymë elektrike.
- Llogaritjet ekonomike për riparimin e parregullsive të sistemit të furnizimit me rrymë elektrike.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit të furnizimit me rrymë elektrike të automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të parapërgatitë vendin e punës dhe automjetin për të mundësuar diagnostikimin e sistemit të furnizimit me rrymë elektrike.
- të përzgjedhë vegla, pajisjet dhe instrumentat e duhura për diagnostikimin e sistemit të furnizimit me rrymë elektrike.
- të marrë informacion paraprak për parregullsitë e sistemit të furnizimit me rrymë elektrike dhe të konsultohet me dokumentacionin teknik përkatës.
- të përzgjedhë procedurat e duhura për diagnostikimin e sistemit të furnizimit me rrymë elektrike.
- të bëjë kontrollin pamor të gjendjes së jashtme të sistemit të furnizimit me rrymë elektrike dhe përcaktimin e parregullsive.
- të bëjë kontrollin e gjendjes së parametrave elektrike dhe të funksionimit të elementeve të ndryshëm të sistemit të furnizimit me rrymë elektrike me përdorimin e instrumentave dhe aparateve përkatëse.
- të përcaktojë drejt parregullsitë e elementeve të sistemit të furnizimit me rrymë elektrike.
- të marrë masat e duhura dhe të ndajë detyrat për riparimin e parregullsive të diagnostikuara.
- të plotësojë dokumentacionin teknik për diagnostikimin dhe riparimin e sistemit të furnizimit me rrymë elektrike.
- të kryejë llogaritjet ekonomike për riparimin e parregullsive të sistemit të furnizimit me rrymë elektrike.
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit të furnizimit me rrymë elektrike.

RM 5 Nxënësi diagnostikon parregullsitë në sistemin e ndezjes së përzjerjes djegëse të automjeteve.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumentave për diagnostikimin e sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik të automjetit.
- Procedurat për diagnostikimin e sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse.
- Kontrolli pamor dhe dëgjimor i gjendjes dhe i funksionimit të elementeve të sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i funksionimit të çelësit të kuadrit për komandimin e sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse dhe përcaktimi i parregullsive.

- Kontrolli në ngarkesë për përcaktimin e kandeles së parregullt.
- Kontrolli i hapësirës së çelësit të elektrodës së kandeles dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i rezistencës elektrike të fijeve të kandelevë dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i rezistencës së izolimit të fijeve të kandelevë dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i parregullsive në distributor dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i rezistencave të përshtjellave primare dhe sekondare të bobinës induktive.
- Kontrolli i tensionit në hyrje të bobinës induktive dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i kohës së ngarkimit të bobinës induktive (*dwell*) me pajisjen përkatëse dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i intensitetit të shkëndijës elektrike në kandelët me anë të testuesit të shkëndijës dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse me pajisje skanuese dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i avancës së dhënies së shkëndijës dhe përcaktimi i parregullsive.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsive të diagnostikuara.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin dhe riparimin e sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse.
- Llogaritjet ekonomike për riparimin e parregullsive të sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse të automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të parapërgatitë vendin e punës dhe automjetin për të mundësuar diagnostikimin e sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse.
- të përzgjedhë vegla, pajisjet dhe instrumentat e duhura për diagnostikimin e sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse.
- të marrë informacion paraprak për parregullsitë e sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse dhe të konsultohet me dokumentacionin teknik përkatës.
- të përzgjedhë procedurat e duhura për diagnostikimin e sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse.
- të bëjë kontrollin pamor të gjendjes së jashtme të sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse dhe përcaktimin e parregullsive.

- të bëjë kontrollin e gjendjes së parametrave elektrike dhe të funksionimit të elementeve të ndryshëm të sistemit të ndezjes së përzierjes djegëse, me përdorimin e instrumentave dhe aparateve përkatëse.
- të përcaktojë drejt parregullsitë e elementeve të sistemit të ndezjes së përzierjes djegëse.
- të marrë masat e duhura dhe të ndajë detyrat për riparimin e parregullsive të diagnostikuara
- të plotësojë dokumentacionin teknik për diagnostikimin dhe riparimin e sistemit të ndezjes së përzierjes djegëse.
- të kryejë llogaritjet ekonomike për riparimin e parregullsive të sistemit të ndezjes së përzierjes djegëse.
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit të ndezjes së përzierjes djegëse

RM 6 Nxënësi diagnostikon parregullsitë në sistemin e ndriçim - sinjalizimit të automjeteve.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e sistemit të ndriçim-sinjalizimit të automjeteve.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumentave për diagnostikimin e sistemit të ndriçim-sinjalizimit.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik të automjetit.
- Procedurat për diagnostikimin e sistemit të ndriçim-sinjalizimit.
- Kontrolli pamor dhe dëgjimor i gjendjes dhe i funksionimit të elementeve të sistemit të ndriçim-sinjalizimit dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i funksionimit të ndriçuesve kryesorë dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i funksionimit të sinjaleve të kthimit dhe të rrezikut dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i funksionimit të sinjaleve të frenimit dhe lëvizjes mbrapa dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i funksionimit të ndriçuesve të kabinës dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i funksionimit të ndriçuesve të aparaturave të kabinës dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i funksionimit të çelësit të komandimit të ndriçuesve dhe sinjalizuesve dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i funksionimit të bories dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli i funksionimit të butonit të komandimit të bories dhe përcaktimi i parregullsive
- Kontrolli i funksionimit të sistemit të alarmit (sigurisë) dhe përcaktimi i parregullsive
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsive të diagnostikuara.

- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin dhe riparimin e sistemit të ndriçim-sinjalizimit të automjetit.
- Llogaritjet ekonomike për riparimin e parregullsive të sistemit të ndriçim-sinjalizimit të automjetit.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit të ndriçim-sinjalizimit të automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të parapërgatitë vendin e punës dhe automjetin për të mundësuar diagnostikimin e sistemit të ndriçim-sinjalizimit.
- të përzgjedhë vegla, pajisjet dhe instrumentat e duhura për diagnostikimin e sistemit të ndriçim-sinjalizimit.
- të marrë informacion paraprak për parregullsitë e sistemit të ndriçim-sinjalizimit dhe të konsultohet me dokumentacionin teknik përkatës.
- të përzgjedhë procedurat e duhura për diagnostikimin e sistemit të ndriçim-sinjalizimit.
- të bëjë kontrollin pamor të gjendjes së jashtme të sistemit të ndriçim-sinjalizimit dhe përcaktimin e parregullsive.
- të bëjë kontrollin e gjendjes së parametrave elektrike dhe të funksionimit të elementeve të ndryshëm të sistemit të ndriçim-sinjalizimit, me përdorimin e instrumentave dhe aparateve përkatëse.
- të përcaktojë drejt parregullsitë e elementeve të sistemit të ndriçim-sinjalizimit.
- të marrë masat e duhura dhe të ndajë detyrat për riparimin e parregullsive të diagnostikuara
- të plotësojë dokumentacionin teknik për diagnostikimin dhe riparimin e sistemit të ndriçim-sinjalizimit.
- të kryejë llogaritjet ekonomike për riparimin e parregullsive të sistemit të ndriçim-sinjalizimit.
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit të ndriçim-sinjalizimit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të zhvillohet në repartin (servisin) e shkollës për shërbimet e automjeteve ose në servise reale automjesh.
- Instruktori duhet të zbatojë sa më shumë demonstrime të procedurave për diagnostikimin e parregullsive në elementet e sistemit elektrik të automjeteve, për ndarjen e detyrave për riparimin, për llogaritjet ekonomike dhe për plotësimin e dokumentacionit përkatës. Rekomandohet që të përdoret metoda e “simulimit të parregullsive” në sistemin elektrik të automjetit.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në

	diskutimet në lidhje me procedurat e diagnostikimit të elementeve të sistemit elektrik të automjetit, si dhe në demonstrimin praktik të procedurave për diagnostikimin e parregullsive në to, për ndarjen e detyrave për riparimin, për llogaritjet ekonomike dhe për plotësimin e dokumentacionit përkatës. – Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të synohet më tepër në verifikimin e shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për të kryer veprimtaritë e diagnostimit dhe menaxhimit. – Instruktori duhet të kërkojë me rreptësi zbatimin nga nxënësit të rregullave të sigurimit teknik në punë, si dhe të nxitë punën në grup të tyre. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kriterëve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimin, të pasjisura si më poshtë: – Repart ose servis për shërbime automjetesh. – Komploti i veglave, pajisjeve dhe instrumentave që mundësojnë diagnostimin e sistemit elektrik të automjetit. – Aparatura diagnostikuese të sistemit elektrik të automjetit. – Automjet mësimor, në gjendje pune. – Dokumentacion teknik dhe formularë që përdoren për aspektet financiare dhe të menaxhimit në punimet e diagnostikimit të sistemit elektrik të automjetit. – Katallogë dhe manuale të automjeteve. – Materiale ilustruese dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul (pankarta, udhëzuesa pune, rregullore, etj.).

3. Moduli “Diagnostikimi i mekanizmave dhe sistemeve të motorit”

Profili: Diagnostikim-menaxhim në autoservis

Niveli: V i KSHK

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	DIAGNOSTIKIMI I MEKANIZMAVE DHE SISTEMEVE TE MOTORIT	M-18-396-10
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i njeh nxënësit me shkaqet e parregullsive dhe me procedurat e diagnostikimit të mekanizmave dhe sistemeve të motorave të tipeve të ndryshme, si dhe i aftëson ata që t’i zbatojnë këto procedura.	
Kohëzgjatja e modulit	132 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat profesionale në degën “Mekanik automobilash”, 5-vjeçare ose 3-vjeçare + 2 vite gjimnaz. - Individë që punojnë në shërbimet e automjeteve dhe që janë të aftë të demonstrojnë aftësi të nivelit 4 në shërbime automobilash.	
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

Udhëzime për zbatimin e modulit	– Ky modul duhet të zhvillohet në repartin (servisin) e shkollës për kryerjen e shërbimeve të automjeteve ose në servise të automjeteve reale – Instruktori duhet të zbatojë sa më shumë demonstrime të procedurave për diagnostikimin e parregullsive në elementet e sistemit të karrocërisë së automjetit, për ndarjen e detyrave për riparimin, për llogaritjet ekonomike dhe për plotësimin e dokumentacionit përkatës. Rekomandohet që të përdoret metoda “simulimit të parregullsive” në sistemin karrocërisë të automjetit. – Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë e të jete të mundur në diskutimet në lidhje me procedurat e diagnostikimit të elementeve të sistemit të karrocërisë së automjetit, si dhe në demonstrimin praktik të procedurave për diagnostikimin e parregullsive në to, për ndarjen e detyrave për riparimin, për llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës. – Gjate vlerësimit të kursanteve duhet të synohet me tepër në verifikimin e shkallës së aftësive praktike që ato kanë fituar për të kryer veprimtaritë e diagnostikimit dhe menaxhimit. – Instruktori duhet të kërkojë nga nxënësit zbatimin me rreptësi të rregullave të sigurimit teknik në punë, si dhe të nxitë punën në grup të tyre. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të kondiserohet plotësimi nga nxënësit i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mesimor të modulit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit.	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimin, të pasigurisë si më poshtë: – Repart ose servis për shërbime të automjeteve. – Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumentave matëse që mundësojnë diagnostikimin e sistemit të karrocërisë së automjetit. – Automjet mesimor dhe rimorkio në gjendje pune. – Dokumentacion teknik dhe formular që përdoren për aspektet financiare dhe të menaxhimit në punimet e diagnostikimit të sistemit të karrocërisë të automjetit. – Materiale ilustruese dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul (pamflet, udhëzues pune, rregullore e sigurimit teknik etj.).

9. Moduli “Diagnostikimi i sistemit të ecjes së automjetit”

Profili: Diagnostikim-menaxhim në autoservis

Niveli: V i KSHK

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	DIAGNOSTIKIMI I SISTEMIT TE ECJES SE AUTOMJETIT	M-18-402-10
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i njeh nxënësit me shkaqet e parregullsive dhe me procedurat e diagnostikimit të elementeve të sistemit të ecjes së automjeteve, si dhe i aftëson ata që ti zbatojnë këto procedura.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat profesionale në degën “Mekanik automobilash”, 5-vjeçare ose 3-vjeçare + 2 vite gjimnaz. - Individë që punojnë në shërbimet e automjeteve dhe që janë të aftë të demonstrojnë aftësi të nivelit 4 në shërbime automobilash.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan sistemin e ecjes së automjetit, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. Përmbajtja: - Ndërtimi i përgjithshëm i sistemit të ecjes së automjetit. - Shasia, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. - Urat, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. - Balestrat e kunderbalestrat, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. - Amortizatorët, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. - Gomat, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. - Disqet, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre - Mocet, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre. - Veglat, pajisjet dhe instrumentat që përdoren për diagnostikimin e sistemit të ecjes së automjetit. - Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit të ecjes së automjetit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë ndërtimin e sistemit të ecjes së automjeteve dhe funksionimin e elementeve të tij - të rendisë parregullsitë kryesore të elementeve të sistemit të ecjes të automjetet e lehta - të përshkruajë shkaqet më të mundshme të parregullsive të elementeve të sistemit të ecjes të automjetet e lehta	

-
- të identifikojë veglat, pajisjet dhe instrumentat që përdoren për diagnostikimin e sistemit të ecjes së automjetit.

RM 2 Nxënësi diagnostikon parregullsitë në shasinë e automjetit.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e shasisë.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumentave për diagnostikimin e shasisë së automjetit.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik të automjetit.
- Procedurat për diagnostikimin e shasisë.
- Kontrolli pamor i gjendjes së jashtme teknike të shasisë dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli me instrumenta mates i gjendjes teknike të shasisë dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli për deformime të konstruksionit të shasisë së automjetit dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli për plasaritje të konstruksionit të shasisë dhe përcaktimi i parregullsive.
- Kontrolli për oksidimin e konstruksionit të shasisë dhe përcaktimi i parregullsive.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsive të diagnostikuara të shasisë së automjetit.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin e riparimit të shasisë së automjetit.
- Llogaritja ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e parregullsive të shasisë.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Kontrollimi i mbarëvajtjes dhe cilësisë së punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit e riparimit të shasisë së automjetit.
- Komunikimi me profesionalizem dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt parregullsitë e shasisë të automjetet e lehta
- të përcaktojë saktë shkaqet e parregullsive të shasisë të automjetet e lehta
- të marrë masat e duhura për riparimin e parregullsive të shasisë të automjetet e lehta
- të komunikojë me profesionalizëm, të plotësojë si duhet dokumentacionin dhe të kryejë llogaritje të sakta ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e shasisë së automjetit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

RM 3 Nxënësi diagnostikon parregullsitë e urave të automjeteve.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e urave të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumentave për diagnostikimin e urave të automjeteve.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik të automjetit.
- Procedurat për diagnostikimin e sistemit të urave të automjetit.
- Kontrolli pamor i gjendjes së jashtme të urave dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli për rrjedhje të vajit të urave dhe pasme të automjetit dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli për plasaritje të urave dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli me instrumenta mates të urave të automjetit dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli për deformimin e spostimeve nga qenderzimi i urave të automjetit dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsisë të diagnostikuara në ura të automjetit.
- Dhënia e informacionit për kohën dhe për koston e shërbimit.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsisë të diagnostikuara në sistemin e ecjes.
- Kontrolli i mbarëvajtjes dhe i cilësisë së punës.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin dhe riparimin e urave të automjetit.
- Llogaritjet ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e parregullsisë të diagnostikuara të urave të automjetit.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Kontrollimi i mbarëvajtjes dhe cilësisë së punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit teknik të urave të automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt parregullsitë e urave të automjetit të lehta.
- të përcaktojë saktë shkaqet e parregullsisë të urave të automjetit të lehta.
- të marrë masat e duhura për riparimin e parregullsisë të urave të automjetit të lehta.
- të komunikojë me profesionalizëm, të plotësojë si duhet dokumentacionin dhe të kryejë llogaritje të sakta ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e urave të automjetit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

RM 4 Nxënësi diagnostikon parregullsitë në balestrat dhe kunderbalestrat e automjeteve.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e balestrave dhe kunderbalestrave të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumentave për diagnostikimin e balestrave dhe kunderbalestrave të automjetit.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik të automjetit.
- Procedurat për diagnostikimin e balestrave dhe kunderbalestrave të automjetit.
- Kontrolli pamor i gjendjes së jashtme të teknikeve të balestrave dhe kunderbalestrave të automjetit, si dhe përcaktimi i parregullive.
- Kontrolli për shkarkimin e fijeve të balestrave dhe kunderbalestrave dhe përcaktimi i parregullive.
- Kontrolli i kavallotave, pernave dhe spinotave të balestrave dhe kunderbalestrave për keputje dhe konsumim, si dhe përcaktimi i parregullive.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullive të diagnostikuara në balestra dhe kunderbalestrat e automjetit dhe përcaktimi i parregullive.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin dhe riparimin e balestrave dhe kunderbalestrave të automjetit.
- Llogaritjet ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e parregullive të diagnostikuara të balestrave dhe kunderbalestrave të automjetit.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Kontrollimi i mbarëvajtjes dhe cilësisë së punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit teknik të balestrave dhe kunderbalestrave të automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt parregullsitë e balestrave dhe kundërbalestrave të automjetit të lehta
- të përcaktojë saktë shkaqet e parregullive të balestrave dhe kundërbalestrave të automjetit të lehta
- të marrë masat e duhura për riparimin e parregullive të balestrave dhe kundërbalestrave të automjetit të lehta
- të komunikojë me profesionalizëm, të plotësojë si duhet dokumentacionin dhe të kryejë llogaritjet të sakta ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e balestrave dhe kundërbalestrave të automjetit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

RM 5 Nxënësi diagnostikon parregullsitë e amortizatoreve të automjeteve.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e amortizatoreve të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumentave për diagnostikimin amortizatoreve të automjetit.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik perkates të automjetit.
- Procedurat për diagnostikimin amortizatoreve të automjetit.
- Kontrolli pamor i i gjendjes së jashtme të amortizatoreve dhe percaktimi i parregullsive.
- Kontrolli me instrumente matëse të gjendjes teknike të amortizatoreve dhe percaktimi i parregullsive.
- Kontrolli për rrjedhje vaji, ajri ose gaz të amortizatorit dhe percaktimi i parregullsive.
- Kontrolli për deformim, keputje të trupit të amortizatoreve dhe percaktimi i parregullsive.
- Kontrolli për konsumim ose çarje të gominave të amortizatorit, percaktimi i parregullsive.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsive të diagnostikuara në amortizatorët e automjetit.
- Kontrolli i mbarëvajtjes dhe i cilësisë së punës.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin dhe për riparimin amortizatorit të automjetit.
- Llogaritjet ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e parregullsive të diagnostikuara të amortizatoreve të automjetit.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit e riparimit të amortizatoreve të automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt parregullsitë e amortizatorëve të automjetit të lehta.
- të përcaktojë saktë shkaqet e parregullsive të amortizatorëve të automjetit të lehta.
- të marrë masat e duhura për riparimin e parregullsive të amortizatorëve të automjetit të lehta
- të komunikojë me profesionalizëm, të plotësojë si duhet dokumentacionin dhe të kryejë llogaritje të sakta ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e amortizatorëve të automjetit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

RM 6 Nxënësi diagnostikon parregullsitë në gomat dhe disqet e automjeteve.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e gomave dhe disqeve të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve e instrumentave për diagnostikimin e gomave dhe disqeve të automjetit.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik përkatës të automjetit
- Procedurat për diagnostikimin e gomave dhe disqeve të automjetit.
- Kontrolli pamor i gjendjes së jashtme të gomave dhe disqeve të automjetit dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli për ballancimin e diskut dhe gomes me pajisjet ballancuese dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli i gomes për plasaritje, çarje dhe konsumim të luleve, si dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli i diskut për deformime dhe çarje dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsisë të diagnostikuara të gomave dhe disqeve të automjetit.
- Kontrolli i mbarëvajtjes dhe i cilësisë së punës.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Kompletimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin e riparimin e gomave dhe disqeve të automjetit.
- Llogaritjet ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e parregullsisë të diagnostikuara të gomave dhe disqeve të automjetit.
- Rregullat e sigurimit teknik, gjatë diagnostikimit dhe riparimit të gomave dhe disqeve të automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt parregullsitë e gomave dhe disqeve të automjetit të lehta.
- të përcaktojë saktë shkaqet e parregullsisë të gomave dhe disqeve të automjetit të lehta.
- të marrë masat e duhura për riparimin e parregullsisë të gomave dhe disqeve të automjetit të lehta
- të komunikojë me profesionalizëm, të plotësojë si duhet dokumentacionin dhe të kryejë llogaritjet të sakta ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e gomave dhe disqeve të automjetit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

RM 7 Nxënësi diagnostikon parregullsitë e “mocave” të rrotave te automjeteve.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e mocave të rrotave të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve e instrumentave për diagnostikimin e mocave të automjetit.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik përkatës të automjetit.
- Procedurat për diagnostikimin e mocave të automjetit
- Kontrolli pamor i gjendjes teknike së jashtme të mocave të automjetit dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli për bllokim dhe për xhoko të mocave, si dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli për thyerje të mocave dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli i kapakeve grasatimit të mocave për deformim e çarje, dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Kontrolli për thyerje e gripime të kushinetave të mocave dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsisë të diagnostikuara të mocave të automjetit.
- Kontrolli i mbarëvajtjes dhe i cilësisë së punës.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Kompletimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin e riparimin e mocave të automjetit.
- Llogaritjet ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e parregullsisë të diagnostikuara të mocave të automjetit.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit e riparimit të mocave të automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt parregullsitë e mocave të automjetit e lehta.
- të përcaktojë saktë shkaqet e parregullsisë të mocave të automjetit e lehta.
- të marrë masat e duhura për riparimin e parregullsisë të mocave të automjetit e lehta
- të komunikojë me profesionalizëm, të plotësojë si duhet dokumentacionin dhe të kryejë llogaritjet të sakta ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e mocave të automjetit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

zbatimin e modulit	kryerjen e shërbimeve të automjeteve ose në servise automjesh reale – Instruktori duhet të zbatojë sa më shumë demonstrime të procedurave për diagnostikimin e parregullsive në elementet e sistemit të ecjes së automjetit, për ndarjen e detyrave për riparimin, për llogaritjet ekonomike dhe për plotësimin e dokumentacionit përkatës. Rekomandohet që të përdoret metoda “simulimit të parregullsive” në sistemin e ecjes të automjetit. – Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë e të jete e mundur në diskutimet në lidhje me procedurat e diagnostikimit të elementeve të sistemit të ecjes së automjetit, si dhe në demonstrimin praktik të procedurave për diagnostikimin e parregullsive në to, për ndarjen e detyrave për riparimin, për llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës. – Gjate vlerësimit të kursanteve duhet të synohet me tepër në verifikimin e shkallës së aftësive praktike që ato kanë fituar për të kryer veprimtaritë e diagnostikimit dhe menaxhimit. – Instruktori duhet të kërkojë me nga nxënësit zbatimin me rreptësi të rregullave të sigurimit teknik në punë, si dhe të nxitë punën në grup të tyre. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të kondiserohet plotësimi nga nxënësit i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mesimor të modulit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit.	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimin, të pasigurisë si më poshtë: – Repart ose servis për shërbime automjesh. – Komploti i veglave, pajisjeve dhe instrumentave matëse që mundësojnë diagnostikimin e sistemit të ecjes së automjetit. – Automjet mesimor në gjendje pune. – Dokumentacion teknik dhe formular që përdoren për aspektet financiare dhe të menaxhimit në punimet e diagnostikimit të sistemit të ecjes të automjetit. – Materiale ilustruese dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul (pamflet, udhëzues pune, rregullore e sigurimit teknik etj.).

10. Moduli “Diagnostikimi me kompjuter i parregullsive të automjetit”

Profili: Diagnostikim-menaxhim në autoservis

Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	DIAGNOSTIKIMI I SISTEMIT KOMPJUTERIK TE AUTOMJETIT	M-18-403-10
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i njeh nxënësit me ndërtimin dhe funksionimin e sistemit kompjuterik dhe pajisjes për leximin e të dhënave (scan tool), me procedurat e diagnostikimit të parregullsive të automjetit dhe të vetë sistemit kompjuterik, si dhe i aftëson ata që t'i zbatojnë këto procedura.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat profesionale në degën “Mekanik automobilash”, 5-vjeçare ose 3-vjeçare + 2 vite gjimnaz. - Individë që punojnë në shërbimet e automjeteve dhe që janë të aftë të demonstrojnë aftësi të nivelit 4 në shërbime automobilash.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e sistemit kompjuterik të automjeteve. Përmbajtja: - Qëllimi i përdorimit të sistemit kompjuterik të automjeteve. - Përparësitë e sistemeve kompjuterike të automjeteve. - Bllok-skema (pjesët përbërëse) dhe parimi i veprimit të sistemit kompjuterik të automjeteve të lehta. - Ndijuesit (sensorët) e sistemit kompjuterik, llojet, mënyra e veprimit dhe roli i tyre në sistemin kompjuterik. - Përpunuesit e sinjaleve (paketat elektronike), llojet, mënyra e veprimit dhe roli i tyre në sistemin kompjuterik. - Vepruesit (zbatuesit) e sistemit kompjuterik, llojet, mënyra e veprimit dhe roli i tyre në sistemin kompjuterik. - Mënyrat e dhënies së informacionit nga sistemi kompjuterik. - Dhënia e informacionit drejtpërdrejt në kroskotin e automjetit (OBD-II – on-board diagnostics) - Parregullsitë që diagnostikohen nga leximi i të dhënave drejtpërdrejt në kroskotin e automjetit, shkaqet e tyre. - Dhënia e informacionit nëpërmjet pajisjes lexuese (scan tool). - Leximi dhe interpretimi i informacionit nga sistemi kompjuterik për gjendjen e funksionimit të automjetit dhe të vetë sistemit kompjuterik. - Dokumentacioni teknik për sistemin kompjuterik të automjetit. - Kujdesi për sistemin kompjuterik të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të tregojë pse përdoret sistemi kompjuterik i automjeteve dhe përparësitë e përdorimit të tij.
- të përshkruajë ndërtimin dhe parimin e veprimit të sistemit kompjuterik të automjeteve të lehta.
- të përshkruajë ndijuesit (sensorët), paketat elektronike dhe zbatuesit e sistemit kompjuterik, si dhe llojet, mënyrat e veprimit dhe rolin e tyre.
- të tregojë cilat janë mënyrat e dhënies së informacionit nga sistemi kompjuterik dhe parregullsitë e automjetit ose të sistemit që diagnostikohen nga leximi i këtij informacioni.
- të bëjë leximin dhe interpretimin e informacionit nga sistemi kompjuterik për parregullsitë e automjetit dhe të vetë sistemit kompjuterik.
- të interpretojë dokumentacionin teknik për sistemin kompjuterik të automjetit.
- të tregojë cilat janë masat për mosdëmtimin e sistemit kompjuterik të automjetit.

RM 2 Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e pajisjes për leximin e të dhënave të sistemit kompjuterik (scan tool).***Përmbajtja:***

- Qëllimi i përdorimit të pajisjes lexuese të të dhënave (scan tool).
- Llojet, ndërtimi, funksionimi dhe përdorimi i pajisjeve lexuese tipike.
- Parregullsitë e automjetit dhe të sistemit kompjuterik që diagnostikohen nga leximi i të dhënave nëpërmjet pajisjes lexuese, shkaqet e tyre.
- Mënyrat e lidhjes së pajisjes lexuese me sistemin kompjuterik të automjetit.
- Mënyrat e vënies në punë dhe të përdorimit të pajisjeve lexuese të llojeve të ndryshme.
- Leximi dhe interpretimi i të dhënave të pajisjeve lexuese të llojeve të ndryshme.
- Dokumentacioni teknik për pajisjet lexuese të sistemit kompjuterik të automjetit.
- Kujdesi për pajisjet lexuese të sistemit kompjuterik të automjetit.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë përdorimit të pajisjeve lexuese të sistemit kompjuterik të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë qëllimin, llojet, ndërtimin, funksionimin dhe

- përdorimin e pajisjeve lexuese tipike.
- të përshkruajë parregullsitë e automjetit dhe të sistemit kompjuterik që diagnostikohen nga leximi i të dhënave nëpërmjet pajisjes lexuese.
 - të tregojë procedurat e lidhjes, të vënies në punë dhe të përdorimit të pajisjes lexuese të sistemin kompjuterik të automjetit.
 - të bëjë leximin dhe interpretimin e të dhënave të pajisjeve lexuese të llojeve të ndryshme.
 - të interpretojë dokumentacionin teknik për pajisjet lexuese.
 - të tregojë kujdesin e duhur për pajisjet lexuese të sistemit kompjuterik të automjetit.
 - të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë përdorimit të pajisjeve lexuese të sistemit kompjuterik të automjetit.

RM 3 Nxënësi diagnostikon me anë të kompjuterit parregullsitë në automjete.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e parregullsive me kompjuter.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumentave për diagnostikimin e e automjetit me kompjuter.
- Marrja e informacionit paraprak për parregullsitë e automjetit.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik të automjetit.
- Lidhja e pajisjes lexuese (scan tool) me sistemin kompjuterik të automjetit.
- Vënia në punë e pajisjes lexuese.
- Procedura për diagnostikimin e parregullsive të automjetit me anë të testit me çelës kuadri “on” por me motor të ndaluar.
- Procedura për diagnostikimin e parregullsive të automjetit me anë të testit me motor të nezur.
- Procedura për diagnostikimin e parregullsive të automjetit me anë të testit të “lëvizjes së fishave dhe përcjellësve”.
- Procedura për diagnostikimin e parregullsive të automjetit me anë të testit të ndezjes/fikjes së çelësve të ndryshëm.
- Procedura për diagnostikimin e parregullsive të automjetit me anë të testit në lëvizje të automjetit.
- Procedura e shkëputjes së pajisjes lexuese nga sistemi kompjuterik.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsive të diagnostikuara me kompjuter.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin dhe riparimet përkatëse.
- Llogaritjet ekonomike për diagnostikimin me kompjuter dhe riparimin e parregullsive përkatëse.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit me kompjuter të parregullsive të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të parapërgatitë vendin e punës dhe automjetin për të mundësuar diagnostikimin e parregullsive të automjetit me kompjuter.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentat e duhura për diagnostikimin e parregullsive të automjetit me kompjuter.
- të marrë informacion paraprak për parregullsitë e automjetit dhe të konsultohet me dokumentacionin teknik përkatës.
- të bëjë lidhjen e pajisjes lexuese (scan tool) me sistemin kompjuterik të automjetit dhe vënien e saj në punë.
- të bëjë diagnostikimin e parregullsive të automjetit me anë të testeve të ndryshme që mundëson pajisja lexuese e të dhënave të kompjuterit.
- të përcaktojë drejt shkaqet e parregullsive të diagnostikuara në automjet.
- të bëjë shkëputjen e pajisjes lexuese nga sistemi kompjuterik.
- të marrë masat e duhura dhe të ndajë detyrat për riparimin e parregullsive të automjetit të diagnostikuara me kompjuter.
- të komunikojë me profesionalizëm, të plotësojë si duhet dokumentacionin dhe të kryejë llogaritje të sakta ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e automjetit me kompjuter.
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të të automjetit me kompjuter.

RM 4 Nxënësi diagnostikon parregullsitë në sistemin kompjuterik të automjetit.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës dhe automjetit për diagnostikimin e parregullsive në sistemin kompjuterik.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumentave për diagnostikimin e parregullsive në sistemin kompjuterik.
- Konsultimi me dokumentacionin teknik të automjetit.
- Kontrolli pamor i elementeve të sistemit kompjuterik (shkëputja e lidhjeve elektrike, dëmtimi i sensorëve, dëmtimi i vepruesve, etj.).
- Lidhja e pajisjes lexuese (scan tool) me sistemin kompjuterik të automjetit.
- Vënia në punë e pajisjes lexuese.
- Interpretimi i informacionit nga pajisja lexuese dhe përcaktimi i elementit që ka parregullsi.
- Procedura për diagnostikimin e parregullsive në ndijuesit (sensorët) e sistemit kompjuterik.
- Procedura për diagnostikimin e parregullsive në paketën elektronike të sistemit kompjuterik.
- Procedura për diagnostikimin e parregullsive në vepruesit e

sistemit kompjuterik.

- Procedura e shkëputjes së pajisjes lexuese nga sistemi kompjuterik.
- Marrja e masave dhe ndarja e detyrave për riparimin e parregullsive të diagnostikuara në sistemin kompjuterik.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin dhe riparimet përkatëse.
- Llogaritjet ekonomike për diagnostikimin e sistemit kompjuterik dhe riparimin e parregullsive përkatëse.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të parregullsive në sistemin kompjuterik të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të parapërgatitë vendin e punës dhe automjetin për të mundësuar diagnostikimin e parregullsive të sistemit kompjuterik të automjetit.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentat e duhura për diagnostikimin e parregullsive të sistemit kompjuterik të automjetit.
- të marrë informacion paraprak për parregullsitë e sistemit kompjuterik të automjetit dhe të konsultohet me dokumentacionin teknik përkatës.
- të bëjë lidhjen e pajisjes lexuese (scan tool) me sistemin kompjuterik të automjetit dhe vënien e saj në punë.
- Të interpretojë drejt informacionin nga pajisja lexuese dhe përcaktojë saktë elementin që ka parregullsi.
- Të bëjë diagnostikimin e parregullsive në ndijuesit (sensorët), paketën elektronike dhe vepruesit e sistemit kompjuterik.
- Të përcaktojë shkaqet e parregullsive të sistemit kompjuterik.
- të bëjë shkëputjen e pajisjes lexuese nga sistemi kompjuterik.
- të marrë masat e duhura dhe të ndajë detyrat për riparimin e parregullsive të sistemit kompjuterik të automjetit.
- të komunikojë me profesionalizëm, të plotësojë si duhet dokumentacionin dhe të kryejë llogaritje të sakta ekonomike për diagnostikimin dhe riparimin e sistemit kompjuterik të automjetit.
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të parregullsive të sistemit kompjuterik të automjetit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të zhvillohet në repartin (servisin) e shkollës për shërbimet e automjeteve ose në servise reale automjesh.
- Instruktori duhet të zbatojë sa më shumë demonstrime të procedurave për diagnostikimin me kompjuter të parregullsive të automjetit, si dhe të vetë sistemit kompjuterik, për ndarjen e

	detyrave për riparimin, për llogaritjet ekonomike dhe për plotësimin e dokumentacionit përkatës. Rekomandohet që të përdoret metoda e “simulimit të parregullsisve” në sistemin kompjuterik të automjetit. – Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në diskutimet në lidhje me procedurat e diagnostikimit të parregullsisve të automjetit dhe të vetë sistemit kompjuterik, si dhe në demonstrimin praktik të procedurave përkatëse, për ndarjen e detyrave për riparimin, për llogaritjet ekonomike dhe për plotësimin e dokumentacionit përkatës. – Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të synohet më tepër në verifikimin e shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për të kryer veprimtaritë e diagnostimit dhe menaxhimit. – Instruktori duhet të kërkojë me rreptësi zbatimin nga nxënësit të rregullave të sigurimit teknik në punë, si dhe të nxitë punën në grup të tyre. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kriterëve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimin, të pasjisura si më poshtë: – Repart ose servis për shërbime automjetesh. – Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumentave që mundësojnë diagnostimin me kompjuter të automjetit. – Pajisje të leximit të të dhënave të kompjuterit (scan tool) të automjetit. – Automjet mësimor, në gjendje pune. – Dokumentacion teknik dhe formularë që përdoren për aspektet financiare dhe të menaxhimit në punimet e diagnostikimit me kompjuter të automjetit. – Katallogë dhe manuale të automjeteve. – Materiale ilustruese dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul (pankarta, udhëzuesat pune, rregulloret, etj.).

11. Moduli “Bazat e trajnimit për kompetenca pune”

Profili: Diagnostikim-menaxhim në autoservis

Niveli: V i KSHK IV

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	BAZAT E TRAJNIMIT PER KOMPETENCA PUNE	M-27-404-10
Qëllimi i modulit	Një modul teorik - praktik që i njeh nxënësit me aspektet themelore të pedagogjisë dhe me veçoritë e procedurave të trajnimit për kompetenca pune, si dhe i aftëson ata ti zbatojnë këto procedura për trajnimin e “çirakëve” në mjediset e servisit për shërbime automjetesh të lehta.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat profesionale në degën “Mekanik automobilash”, 5-vjeçare ose 3-vjeçare + 2 vite gjimnaz. - Individë që punojnë në shërbimet e automjeteve dhe që janë të aftë të demonstrojnë aftësi të nivelit 4 në shërbime automobilash.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësi programon trajnimin e “çirakëve” për përvetësimin e kompetencave të punës. Përmbajtja: - Kuptimi për kompetencat e punës. - Veçoritë e trajnimit për kompetenca pune. - Analiza e nevojave për trajnim të çirakëve. - Aspekte të pedagogjisë referuar trajnimit për kompetenca pune. - Kuptimi për objektivat, përmbajtjet (veprimtaritë) dhe metodat mësimore, për instrumentet e vlerësimit, për kohën dhe për mjedisin/mjetet mësimore - Struktura e një programi trajnimi për kompetenca pune. - Hapat kryesore për realizimin e trajnimit për kompetenca pune. - Krijimi i mjedisit dhe kushteve të përshtatshme për trajnimin për kompetenca pune. - Veçoritë e shpjegimit dhe ilustrimit të aspekteve teorike të kompetencës. - Veçoritë e demonstrimit praktik të procedurave të kompetencës. - Veçoritë e praktikimit të çirakëve nën mbikqyrjen e trajnuesit. - Veçoritë e praktikimit të pavarur të çirakëve deri në arritjen e kompetencës. - Aspekte e komunikimit me çirakët dhe të motivimit të tyre gjatë trajnimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë veçoritë e kompetencave të punës dhe të trajnimeve për arritjen e kompetencave të punës.
- të kryejë një analizë të shpejtë të nevojave për trajnim të çirakëve.
- të përshkruajë aspektet më themelore të pedagogjisë referuar trajnimit për kompetenca pune.
- të përkufizojë dhe të japë shembuj të objektivave, përmbajtjeve (veprimtarive) dhe metodave mësimore, të instrumenteve të vlerësimit, të kohës dhe të mjedisit/mjeteve mësimore të nevojshme për realizimin e trajnimit.
- të përshkruajë strukturën e një programi trajnimi për kompetenca pune.
- të rendisë dhe përshkruajë hapat kryesore për realizimin e trajnimit për kompetenca pune (krijimin e mjedisit dhe kushteve, shpjegimin e aspekteve teorike, demonstrimin e praktik të procedurave të punës, praktikimin nën mbikqyrje dhe praktikimin e pavarur.
- të përshkruajë aspektet themelore të komunikimit me çirakët dhe të motivimit të tyre gjatë trajnimit.

RM 2 Nxënësi kryen trajnime të çirakëve për përvetësimin e kompetencave të punës.***Përmbajtja:***

- Analizimi i nevojave për trajnim të “çirakëve” (të simuluar të autoservisit)
- Analiza e kompetencës së punës për të cilën do të bëhet trajnimi.
- Përgatitja e programit të trajnimit të çirakëve për kompetencën përkatëse.
- Përgatitja e mjedisit të trajnimit me mjetet dhe pajisjet e duhura.
- Përgatitja e udhëzuesve të shkruar për procedurat e punës.
- Realizimi i udhëzimeve paraprake, i shpjegimeve dhe i ilustrimeve të aspekteve teorike të kompetencës së punës.
- Kryerja e demonstrimeve të procedurave të punës për kompetencën përkatëse.
- Mbikqyrja e praktikimit të çirakëve për procedurat e punës.
- Udhëzimi i çirakëve gjatë praktikimit të procedurave të punës.
- Krijimi i kushteve për praktikimin e pavarur të çirakëve për procedurat e punës.
- Komunikimi dhe motivimi i çirakëve gjatë trajnimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të bëjë një analizë të shpejtë të nevojave për trajnim të “çirakëve” (të simuluar) në autoservis.
- të analizojë drejt elementet teorike dhe praktike të kompetencës së punës për të cilën do të bëhet trajnimi.
- të përgatisë programin e trajnimit të çirakëve për kompetencën përkatëse.
- të parapërgatisë mjedisin e autoservisit, me mjetet dhe pajisjet e duhura për trajnimin e kompetencës përkatëse.
- të parapërgatisë udhëzues të shkruar për procedurat e punës gjatë trajnimit.
- të japë udhëzime paraprake dhe të shpjegojë e ilustrojë aspektet teorike të kompetencës së punës.
- të demonstrojë procedurat korrekte të punës për kompetencën përkatëse.
- të mbikqyrë dhe të udhëzojë çirakët gjatë praktikimit të procedurave të punës.
- të krijojë kushtet e duhura për praktikimin e pavarur të çirakëve për procedurat e punës.
- të insistojë në zbatimin e rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit nga çirakët, gjatë trajnimit.
- të komunikojë drejt dhe të motivojë çirakët gjatë trajnimit.

RM 3 Nxënësi kryen vlerësimin e “çirakëve” gjatë procesit të trajnimit për kompetenca pune.**Përmbajtja:**

- Përcaktimi i aspekteve teorike dhe praktike që do të vlerësohen te çirakët.
- Parapërgatitja e pyetjeve gojore për të cilat do të pyeten çirakët.
- Përgatitja e “listave të kontrollit” për vlerësimin e shkallës së realizimit të procedurave të punës.
- Realizimi i vlerësimit teorik të çirakëve me anë të pyetjeve gojore.
- Realizimi i vlerësimit praktik të çirakëve me anë të “listave të kontrollit”.
- Vlerësimi i çirakëve për aspekte të komunikimit dhe të sjelljes gjatë trajnimit praktik.
- Evidentimi në dokumentacion i rezultateve të vlerësimeve.
- Analizimi dhe dhënia e rezultateve të vlerësimeve të çirakëve.
- Marrja e masave për përmirësimin e procesit të trajnimit të çirakëve për kompetenca pune.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt aspektet teorike dhe praktike që do të vlerësohen te çirakët.
- të bëjë parapërgatitjen e pyetjeve gojore të duhura për të vlerësuar çirakët.
- të bëjë parapërgatitjen e “listave të kontrollit” për vlerësimin e shkallës së realizimit të procedurave të punës.
- të bashkëbisedojë me çirakët gjatë trajnimit, për të bërë vlerësimin me pyetje gojore, të aspekteve teorike të përgatitjes së tyre.
- të mbikqyrë punën e çirakëve, për të bërë vlerësimin me “listë kontrolli” të aspekteve praktike të përgatitjes së tyre.
- të mbikqyrë veprimtarinë e çirakëve për të bërë vlerësimin e aspekteve të komunikimit dhe të sjelljes së tyre.
- të plotësojë dokumentacionin për rezultatet e vlerësimeve.
- të analizojë dhe ti japë çirakëve rezultatet e vlerësimeve për arritjet e tyre.
- të marrë masat e duhura për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të trajnimit të çirakëve për kompetenca pune.

**Udhëzime për
zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë mësimore (për aspektet teorike), si dhe në repartin (servisin) e shkollës për shërbimet e automjeteve ose në servise reale automjesh.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë ilustrime dhe shembuj të njohurive teorike që trajtohen në modul, si dhe demonstrime të procedurave të analizës dhe trajnimit për kompetenca pune.
- Instruktori duhet të ofrojë formate të programit të trajnimit, udhëzuesve të punës, listave të kontrollit, evidencave të vlerësimit dhe dokumentacionit tjetër që përdoret gjatë trajnimit përkatës.
- Gjatë trajnimit, rekomandohet që të përdoret metodat e “simulimit” dhe të “lojës me role”, ku nxënësit në kurs alternojnë rolet e “trajnerit” dhe të “çirakut”. Rekomandohet dhe metoda e “rotacionit” të vendeve të punës gjatë trajnimit në autoservis, për të mundësuar që të përmbushen kompetenca të ndryshme pune.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në diskutimet në lidhje me aspektet teorike të trajnimit për kompetenca pune, si dhe në demonstrimin praktik të hapave dhe procedurave të trajnimit (analizë nevojash, planifikim, parapërgatitje, shpjegim dhe ilustrim, demonstrim, mbikqyrje dhe udhëzim, vlerësim, motivim, plotësim dokumentacioni, etj.).
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të synohet më tepër në verifikimin e shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për të kryer veprimtaritë e trajnimit të çirakëve për kompetenca pune.
- Instruktori duhet të kërkojë me rreptësi zbatimin nga nxënësit të rregullave të sigurimit teknik gjatë trajnimit për kompetenca pune, si dhe të nxitë punën në grup të tyre.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kriterëve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimi, të pasjisura si më poshtë:

- Klasë mësimore për aspekte teorike të trajnimit
 - Repart ose servis për shërbime automjetesh.
 - Automjet mësimor, në gjendje pune.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumentave që mundësojnë demonstrimet praktike për qëllime trajnimi.
 - Formate dokumentesh që përdoren gjatë trajnimit për kompetenca pune.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-